

# Fëmija ynë hyn në shkollë

## Këshilla për prindërit



Kalimi nga kopshti i fëmijëve për në shkollën primare është një hap i madh dhe i rëndësishëm për fëmijën tuaj. Pas dy vjetësh në kopshtin e fëmijëve, pjesa e madhe e fëmijëve është e përgatitur për këtë ndryshim dhe e pret shkollën me gëzim.

Këtu gjeni disa mendime dhe këshilla, se si ju mund ta përgatitni fëmijën tuaj për kalimin në shkollën primare.

## Kështu mund ta përkrahni fëmijën tuaj

**Duke folur pozitivisht rreth shkollës:** Flisni pozitivisht rreth shkollës. Fëmija juaj duhet të presë atë me gëzim. Me një pikëpamje pozitive, hyrja del më mirë.

**Rregulla dhe rite:** Fëmija juaj ka nevojë për rregulla dhe rende të njohura veprimi. Është e dobishme në shkollë, nëse fëmija juaj është i aftë për t'u përshtatur dhe nëse e di, që ekzistojnë rregulla dhe që ai duhet t'i mbajë.

**Shëndeti:** Kini kujdes për shëndetin e fëmijës suaj, p.sh. që të fle mjaftueshëm. Të ushqyerit me balancim, një mëngjes dhe/ose një vakt «Znëni» e ndihmojnë fëmijën tuaj të përqendrohet. Edhe lëvizja e mjaftueshme është e rëndësishme, me qëllim që ai në shkollë të mund të dëgjojë mirë dhe të punojë qetë.

**Konsumi i medieve:** Kini kujdes për një konsum mediesh të kufizuar (televizor, celular, kompjuter, aparate elektronike lojërash) dhe vështrojeni fëmijën gjatë kësaj. Shumë kohë para televizorit dhe me lojëra kompjuterike ndikojnë keq në përqendrim. Fëmijët 6- deri 9-vjeçarë nuk duhet të kenë më shumë se 5 orë kohë në javë para ekranit.

**Veprimet e jetës së përditshme:** Përkrahjeni fëmijën tuaj në rrugën e tij drejt pavarësisë. Tregojani atij, se si ai mund të ndërrohet për shembull për fizkulturën, lëreni atë të marrë përsipër një përgjegjësi të vogël ose jepni atij porosi të vogla.

**Rruga për në shkollë:** Ushtroni bashkë me fëmijën tuaj rrugën për në shkollë, derisa ai mund ta bëjë atë vetëm dhe në mënyrë të sigurt. Fëmija juaj është krenar, nëse ai tashme e njih rrugën dhe godinën e shkollës.

**Besimi në vetvete:** Forcojeni fëmijën tuaj duke iu besuar atij diçka. Nëse e ruani fëmijën tepër, kjo e dobëson besimin e tij të shëndoshë në vetvete dhe e pengon që ai të mësojë më tepër.

**Zhvillimi:** Çdo fëmijë ka shpejtësinë e vet në të mësuarin. Mos e krahasoni fëmijën tuaj me të tjerët. Shfaqni gëzim në këtë çfarë fëmija juaj e di. Lëvdojeni mundimet e tij, jo vetëm rezultatit.

**Mbështetja e përgjithshme:** Merrni kohë. Lëroni fëmijën tuaj të ndihmojë në jetën e përditshme. Organizojeni kohën e përbashkët me variacione. Mos i merrni përsipër përgjegjësitë që i takojnë fëmijës suaj. Fëmija juaj mëson shumë dhe kënaqet, nëse ai mund të provojë vetë.

**Nxitje e qëllimshme shkollore:** Mos u merakosni në lidhje me mësimin e të lexuarit, të të llogariturit dhe të të shkruarit. Këto gjëra i mëson fëmija juaj në shkollë.

**Gjuha:** Bëni muhabet me fëmijën tuaj, shfaqni mirëkuptim dhe tregojeni interes për këtë, çfarë ai ju tregon. Lexojani atij për shembull histori dhe diskutoni rreth këtyre.

**Motivimi për të mësuar:** Interesohuni për këtë, çfarë bën fëmija juaj. Fëmijët kanë dëshirë të gëzojnë prindërit e tyre. Gëzimi juaj për veprimtarinë e tij është nxitja më e mirë për zhvillimin e tij të mëtejshëm.

**Bashkëpunimi:** Fëmija juaj mëson më mirë, nëse ai përjeton, që prindërit dhe shkolla bashkëpunojnë mirë. Mbani kontakt të vazhdueshëm me shkollën.

## Çfarë duhet të dini

### A është i paracaktuar momenti i hyrjes në shkollë?

Sipas Ligjit të Shkollës Publike të kantonit Thurgau, fëmija juaj ndjek për dy vjet kopshtin e detyrueshëm të fëmijëve dhe pastaj hyn në shkollën primare.

### Kur është një fëmijë gati për shkollën?

Në momentin e hyrjes në shkollë, fëmijët gjinden në shkallë të ndryshme zhvillimi. Të mbështetet secili fëmijë në zhvillimin e tij në mënyrë optimale, kjo qëndron në qendër të shkollës. Shkolla, prindërit dhe persona të tjerë referimi japin së bashku një kontribut të rëndësishëm për këtë.

### A ka përjashtime nga hyrja e rregullt në shkollë?

Ër arsye të rëndësishme, hyrja në shkollën primare mund bëhet një vit më herët ose mund të shtyhet për një vit. Zyra Arsimore vendos për përjashtime përkatëse. Nëse qëndron dëshira për të tejkaluar një vit, duhet të kërkohet sa më parë mendimi i psikologes shkollore resp. të psikologut shkollor.

### Si mund të dalë hyrja në shkollë e suksesshme?

Hyrja në shkollë atëherë del e suksesshme, nëse të gjithë pjesëmarrësit janë plot shpresë, nëse gjithçka është përgatitur mirë dhe nëse fëmija e pret shkollën me gëzim.

### Çfarë mund të bëni ju kur ndiheni i/e pasigurt?

Drejtohuni personit edukues të kopshtit të fëmijëve, nëse keni pyetje rreth kalimit në shkollën primare ose nëse keni merak, në qofte se fëmija juaj është gati për shkollën.

Nëse doni një mendim të dytë ose nëse jeni i/e pasigurt për zhvillimin emocional, social, intelektual ose gjuhësor të fëmijës suaj, atëherë drejtohuni degës «Psikologjia shkollore dhe shkollor».

## Këshillimi i psikologjisë shkollore për prindër

### Zyrat rajonale

**Amriswil**, Kirchstrasse 1, 8580 Amriswil, 058 345 74 60

**Frauenfeld**, Grabenstrasse 11, 8510 Frauenfeld, 058 345 74 30

**Kreuzlingen**, Konstanzerstrasse 13, 8280 Kreuzlingen, 058 345 74 80

Më shumë informacione merrni tek: [www.av.tg.ch](http://www.av.tg.ch)

Nr. i artikullit 5805.98.01, 05/2018 | Albanisch